
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

Nr: 40/2024	Nr: Protokoli: 68/2024
Për:	ANDIDENTme adresë në Ferizaj
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës -Refuzohet
Datë:	18.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022për Prokurim Publik , sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **17.07.2024** nga Operatori Ekonomik: : **ANDIDENTme adresë në Ferizaj**lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **:Blerja dhe pajisja me aparatura te nevojshme për QKMF Rexhep Kuqi - 2 lot - Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshmemjekësore, - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorikeme Numër të prokurimit:624-24-4917-1-2-1Numër i brendshëm624-24-45-121** nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet Kërkesa për Rishqyrtim si pjesërisht e bazuar, e parashtruar nga Operatori **ANDIDENTme adresë në Ferizaj**lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **: Blerja dhe pajisja me aparatura te nevojshme per QKMF Rexhep Kuqi - 2 lot - Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshmemjekësore - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorike me Numër të prokurimit:624-24-4917-1-2-1Numër i brendshëm624-24-45-121** kundër: (NJOFTIMIT PER KONTRATE TE AK) , të datës **01.07.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

- I. Autoriteti Kontraktues vendos të bëjë korigjimin e aktivitetit te prokurimit te lartcekur.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

ANDIDENT me adresë në Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : Blerja dhe pajisja me aparatura te nevojshme për QKMF Rexhep Kuqi - 2 lot - Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshme mjekësore, - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorike me Numër të prokurimit:624-24-4917-1-2-1 Numër i brendshëm: 624-24-45-121

Kundër (NJOFTIMIT PER KONTRATE TE AK) , të datës: **01.07.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **17.07.2024** sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me pretendimet ankimore të shkeljeve të dispozitave ligjore të: Nenit 7 (barazia në trajtim jo diskriminim) nenin 28 (Specifikimet Teknik) si dhe te kërkesave ne DT

Përgjigjeje ndaj pretendimeve ankimore

Përgjigjeje ndaj pretendimit ankimor me Nr. 1 - Pretendimit ankimor me Nr. 1 është i pa bazuar dhe nuk qëndron ngase Autoriteti Kontraktues - Komuna e Suharekës asnjëherë nuk pretendon të diskriminoj ndonjë OE duke favorizuar apo diskriminuar ndonjë OE tjetër. Fotot e vendosura të pajisjeve janë vendosur vetëm për ilustrim dhe informim të OE-ve dhe janë transparente për të gjithë OE.

Përgjigjeje ndaj pretendimit ankimor me Nr. 2- Pretendimit ankimor me Nr. 2 gjithashtu nuk qëndron ngase, sipas informatave nga njësia e kërkesës ka kompani të mjaftueshme qe posedojnë këto produkte te përcaktuara me specifikime teknike, Për më tepër ky aktivitet i Prokurimit ka të bëjë me furnizim dhe jo shërbim ose punë dhe gjithashtu sipas nenit 71 të LPP-ës Operatorët Ekonomik për ta plotësuar njëri tjetrin kane mundësi krijim të GOE (konzercium). **Natyrisht që është i nevojshëm edhe testimi i produkteve veçanërisht për këtë lëndë të Kontratës që është mjaft e ndjeshme dhe shërben për pacient.**

Përgjigjeje ndaj pretendimeve ankimor me Nr. 3 dhe 4

Pretendimet ankimore me Nr. 3 dhe 4 sa i përket Lot 1 dhe Lot 2 për ISO-ët 9001 dhe 13485, po ashtu nuk qëndrojnë sepse AK ka vendosur kriteret sipas standardeve evropiane që kërkohen për këto aparatura. ISO 9001 është një standard i njohur globalisht për menaxhimin e cilësisë. Ndhmon organizatat e të gjitha madhësive dhe sektorëve të përmirësojnë performancën e tyre, të përmbushin pritshmëritë e klientëve dhe të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj cilësisë, pra është standard që ka të bëjë direkt me aktivitetin që AK ka iniciuar. ISO 13485 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një organizatë duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar pajisje mjekësore dhe shërbime të lidhura me to që plotësojnë vazhdimisht kërkesat rregullatore të klientit dhe ato të aplikueshme. Organizata të tilla mund të përfshihen në një ose më shumë faza të ciklit jetësor, duke përfshirë projektimin dhe zhvillimin, prodhimin, ruajtjen dhe shpërndarjen, instalimin ose servisimin e një pajisjeje mjekësore dhe projektimin dhe

zhvillimin ose ofrimin e aktiviteteve të ndërlidhura (p.sh. mbështetjen teknike). ISO 13485 mund të përdoret gjithashtu nga furnitorë ose palë të jashtme që ofrojnë produkte, duke përfshirë shërbime të lidhura me sistemin e menaxhimit të cilësisë për organizata të tilla. ISO 13485 ka të bëjë për aparatura mjekësore ku prodhuesi duhet të jetë i certifikuar.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor me Nr. 5- Pretendimit ankimor me Nr. 5 AK e cilëson si të bazuar dhe kërkesën e tillë do e korrigjon dhe do të veproj në bazë të nenit 53 të LPP.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit


Komuna e Suharekë

